Në bazë të nenit 25, paragrafit (4), të Ligjit për Arsim Profesional dhe Trajnim („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 3/25, 74/25 dhe 111/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

RREGULLORE

për normat dhe standardet për kushtet hapësinore, kuadrin dhe pajisjet për organizimin e trajnimeve për mentorë

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen normat dhe standardet për kushtet hapësinore, kuadrin e nevojshëm dhe pajisjet për organizimin dhe realizimin e trajnimeve për mentorë.

Neni 2

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga odat dhe qendrat rajonale për arsim profesional dhe trajnim , si organizatorë të trajnimeve për mentorë.

Neni 3

Trajnimet për mentorë realizohen në ambiente që i plotësojnë kushtet themelore hapësinore dhe teknike.

Neni 4

Ambienti në të cilin realizohen trajnimet për mentorë duhet të ketë ndriçim të përshtatshëm natyror dhe artificial, si dhe të sigurohet ajrosje e rregullt ose klimatizim i tij.

Neni 5

Në ambientin ku realizohen trajnimet për mentorë, sistemimi i mobilieve duhet të mundësojë punë interaktive. Mobiliet duhet të jenë të lëvizshme dhe të përshtatshme për organizimin e punës në grupe.

Neni 6

Ambienti në të cilin realizohen trajnimet për mentorë duhet të sigurojë akustikë të përshtatshme dhe kushte për komunikim të papenguar.

Neni 7

Mundësisht, organizatori i trajnimit për mentorë të sigurojë ambiente shtesë për punë në grupe dhe pushim.

Ambientet në të cilat organizohen trajnimet për mentorë duhet t'i plotësojnë kushtet themelore higjienike dhe të sigurohet qasje deri te ambientet sanitare.

Organizatori i trajnimit duhet të sigurojë qasje për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 8

Trajnimet për mentorë realizohen nga trajnues (trajnerë) të cilët i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- të kenë arsim të lartë, së paku nivelin VI të kualifikimit, në përputhje me (KKK), si dhe të kenë fituar së paku 240 kredi SETK.
- të kenë së paku pesë vjet përvojë pune në fushën e arsimit dhe/ose mentorimit.
- të posedojnë certifikatë për trajnim të mentorëve për arsimin praktik.

Neni 9

Për çdo trajnim për mentorë, organizatori i trajnimit cakton koordinator të trajnimit, si person teknik të trajnimit.

Koordinatori është përgjegjës për organizimin, komunikimin dhe monitorimin e realizimit të trajnimit.

Neni 10

Trajnimi për mentorë realizohet me pajisjet bazë si në vijim:

- Kompjuter ose laptop;
- Projektor dhe ekran ose tabelë interaktive;
- Tabelë flipçart me markerë.

Neni 11

Në objektin ku realizohen trajnimet për mentorë duhet të sigurohet lidhje stabile me internetin. Sipas nevojës, përdoren platforma dhe mjete digjitale për të nxënit.

Neni 12

Organizatori i trajnimeve për mentorë duhet të sigurojë kushte për siguri, duke përfshirë:

- pajisje për mbrojtje kundër zjarrit;
- plan për evakuim, i vendosur në vend të dukshëm, me dalje të shënuara qartë për rastet e evakuimit;
- kuti për ndihmën e parë;
- ventilim dhe klimatizim në ambiente;
- higjienë e rregullt dhe kushte sanitare.

Neni 13

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e miratimit të saj.

Nr. 13-14597/1

25.11. 2026

Министер за образование и наука,
Ministër i Arsimit dhe Shkencës,

проф. д-р Весна Јаневска p.d